



SHTRENJTOHET RRYMA PËR 16 PËR QIND NË KOSOVË, PARALAJMËROHEN PROTESTA TË VAZHDUESHME

FAQE 4-5



Me thirjet "Asnjë cent më shumë" qytetarë të shumtë kanë protestuar të premten në sheshin "Zahir Pajaziti" duke kundërshtuar shtrenjtimin e rrymës, pak orë pasi Bordi i Zyrës së Rregullatorit të

Energjisë e Kosovës (ZRRë) miratoi vendimin për shtrenjtim të rrymës për 16 për qind më shumë. Njëri nga organizatorët e protestës nga grupi "Asnjë cent më shumë", tha se bordi i ZRRë-së i ka shpërfillur

kërkesat e qytetarëve dhe paralajmëroi vazhdimin e protestave. Ai gjithashtu tha se do të dorëzojnë padi ndaj vendimit të ZRRë-së më 14 prill në Gjykatën Themelore në Prishtinë


**KRASNIQI:
NËSE LV-JA
S'MUNDET
TA FORMOJË
QEVERINË,
RADHA ËSHTË
E JONA** F. 3



**PRESIDENTI I SHOQPËRISË
NDEROHET ME TITULLIN
'DOCTOR HONORIS CAUSA'
NGA UNIVERSITETIT
'KADRI ZEKA' DHE
'QYTETAR NDERI' I
KOMUNËS SË GJILANIT** F. 7



AKTUALE



**KINA I KUNDËRPËRGJIGJET SHBA-së
ME TARIFË PREJ 125 PËR QIND** F. 2

**HOTI: LDK-ja DUHET
TË RIORGANIZOHET PËRMES
NJË PROCESI ZGJEDHOR** F. 5

**HYN NË FUQI MARRËVESHJA PËR
NJOHJEN E PATENTSHOFERËVE
NDËRMJET KOSOVËS DHE EMIRATEVE** F. 7

EKONOMI



**ÇMIMET E KONSUMIT 2.9% MË TË
SHTRENJTA SESA NË TË NJËJTËN
PERIUDHË TË VITIT TË KALUAR** F. 8

**ÇMIME TË ULËTA, TARIFA TË
LARTA: SI NDIKON NË TREGUN
KOSOVAR LUFTA TREGTARE
SHBA-KINË?** F. 8

SPORT



**NË FUNDJAVË DUELET E DYTA TË
'PLAY-OFF'-IT** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVIÇË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kina i kundërpërgjigjet ShBA-së me tarifë prej 125 për qind

PEKIN, 11 PRILL - Kina njoftoi të premten se e ka rritur tarifën ndaj mallrave amerikane nga 84 për qind në 125 për qind, duke iu kundërpërgjigjur presidentit amerikan, Donald Trump, i cili ditë më parë e rriti tarifën ndaj mallrave kineze në 145 për qind. Tarifa e re e Pekinit për mallrat e importuara nga Shtetet e Bashkuara do të hyjë në fuqi të shtunën. Kina kishte paralajmëruar se do t'i luftonte tarifat amerikane me kundërmasa, duke i cilësuar veprimet e Trumpit si "bullizëm ekonomik". Veprimet e Trumpit për tarifa ndaj të gjitha vendeve të botës bënë që drejtuesit e bizneseve të paralajmëronin për recesion të mundshëm ekonomik. Disa

nga partnerët më të mëdhenj tregtarë të ShBA-së u hakmorën duke vendosur taksa ndaj mallrave amerikane, megjithatë Trump njoftoi një pezullim 90 ditor. Por, Trump dhe Kina vazhduan tarifat reciproke ndaj njëri-tjetrit. "ShBA-ja, duke rritur tarifa anormale ndaj Kinës, është kthyer në një lojë numrash, e cila nuk ka asnjë rëndësi praktike ekonomike, dhe do të shndërrohet në një shaka në historinë e ekonomisë botërore", tha një zëdhënës i Ministrisë së Financave të Kinës në një komunikatë. "Megjithatë, nëse ShBA-ja këmbëngul të vazhdojë t'i shkelë në mënyrë të konsiderueshme interesat e Kinës, Kina do të



kundërpërgjigjet me vendosmëri dhe do të luftojë deri në fund", tha ai. Ministria e Tregtisë e Kinës tha

se do ta dorëzojë një tjetër padi në Organizatën Botërore të Tregtisë kundër tarifave amerikane.

Javën e kaluar, Pekini pezulloi importet e sorgumit dhe shpendëve nga disa kompani amerikane, vendosi më shumë kontrolle eksporti mbi mineralet e rralla, të cilat janë thelbësore për teknologji të ndryshme, dhe vendosi disa dhjetëra kompani amerikane në lista që ua ndalojnë kompanive kineze t'u shesin atyre mallra për përdorim të dyfishtë. Duke pasur parasysh madhësinë e dy ekonomive, ekspertët kanë frikë se do të ketë trazirë ekonomike globale. Kreu i OBT-së, Ngozi Okonjo-Iweala, tha më herët këtë javë se lufta tregtare midis ShBA-së dhe Kinës "mund ta dëmtojë rëndë perspektivën ekonomike globale".

Britania njofton 580 milionë dollarë ndihmë ushtarake për Ukrainën

LONDËR, 11 PRILL - Britania e Madhe njoftoi të premten se Ukrainës do t'i ndahen 580 milionë dollarë ndihmë ushtarake, në prag të samitit të Grupit të Kontaktit për Ukrainën. Britania tha se, në bashkëpunim me Norvegjinë, 580 milionë dollarë do të shpenzohen për ta ndihmuar Kievin me qindra mijëra dronë luftarakë, sisteme të radarëve dhe mina antitanke, si dhe për kontrata për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve të blinduara të Ukrainës. Sekretari i Mbrojtjes i Britanisë, John Healey dhe ministri i Mbrojtjes i Gjermanisë, Boris Pistorius, do ta udhëheqin bashkërisht



samitin e 27-të të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës të premten. Në prag të takimit në Bruksel, ministri i Mbrojtjes i Ukrainës,

Rustem Umerov, tha se çështje me rëndësi është forcimi i mbrojtjes ajrore të vendit të tij. "Ukraina ka nevojë për një numër të mjaftueshëm

sistemesh moderne si ato të tipit Patriot", tha ai në një postim në rrjetet sociale. "Nevojitet një vendim politik për furnizimin e këtyre sistemeve, me qëllim mbrojtjen e qyteteve, fshatrave dhe jetës së njerëzve tanë - veçanërisht nga kërcënimi i armëve balistike të Rusisë. Partnerët tanë kanë sisteme të tilla në dispozicion", tha Umerov. Forcat ruse e kanë përparësinë në luftën në Ukrainë, e cila tashmë ka hyrë në vitin e saj të katërt. Zyrtarët ukrainas dhe analistët ushtarakë besojnë se Rusia po përgatitet ta nisë një ofensivë të re ushtarake në javët në vijim, për ta rritur trysinë dhe për t'i

forcuar pozitat e Kremlinit në bisedimet për armëpushim. Takimet e Grupit të Kontaktit për Ukrainën janë kryesuar nga sekretari amerikan i Mbrojtjes deri në çastin kur Donald Trump e mori detyrën si president në janar. Prej atëherë, Healey e ka marrë përsipër këtë detyrë, duke kryesuar takimin e tij të parë në shkurt. Ministria britanike e Mbrojtjes tha se paketa e re dhe "e madhe" e mbështetjes ushtarake do të dorëzohet nga furnizues britanikë dhe ukrainas për të ndihmuar në përformimin e Forcave të Armatosura të Ukrainës në luftën e tyre për t'u mbrojtur nga sulmet ruse.

OBSH kërkon më shumë angazhim në luftën kundër fruthit

GJENEVË, 11 PRILL - Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) bëri thirrje për përpjekje më të mëdha në luftën kundër fruthit, i cili është përhapur në 58 shtete, përfshirë Shtetet e Bashkuara ku kanë vdekur dy fëmijë. Agjencia e Kombeve të Bashkuara, me seli në Gjenevë, theksoi se vaksina kundër fruthit është e sigurt dhe efektive. "Dua t'iu rikujtoj njerëzve se fruthi është një nga viruset më ngjitëse", tha Kate O'Brien, drejtore shë e departamentit të vaksinave në OBSH.

Gjatë konferencës për media, ajo shmangu kritikën ndaj presidentit amerikan, Donald Trump, dhe sekretarit amerikan të Shëndetësisë, Robert Kennedy Jr., i cili njihet si skeptik i vaksinave. Kennedy është akuzuar se nuk po bën mjaftueshëm për të luftuar shpërthimin vdekjeprurës të fruthit, që ka epiqendrën në Teksas, ku janë regjistruar qindra raste. Ai vetëm së voni ka pranuar efektivitetin e vaksinës kundër fruthit. "ShBA-ja është duke punuar për ta vënë nën kontroll dhe për ta ndaluar këtë



shpërthim", tha O'Brien. Megjithatë, ajo shtoi se "për secilin shtet, për aq kohë që një shpërthim vazhdon, nuk mund të bëhet mjaftueshëm. Mund të themi se po bëhet mjaftueshëm vetëm kur shpërthimi të ketë përfunduar", theksoi O'Brien. Ajo tha se sëmundja po përhapet për shkak të rënies së nivelit të vaksinimit, kjo pjesërisht si pasojë e pengesave të shkaktuara nga shpërthimi i pandemisë Covid-19. "Vaksina kundër fruthit është një vaksinë jashtëzakonisht e sigurt dhe jashtëzakonisht efektive", tha O'Brien.

PRESIDENTI I SHQIPËRISË NDEROHET ME TITULLIN “DOCTOR HONORIS CAUSA” NGA UNIVERSITETIT “KADRI ZEKA” DHE “QYTETAR NDERI” I KOMUNËS SË GJILANIT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

GJILAN, 11 PRILL - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, është nderuar të premten në Kosovë me dy çmime. Ai është nderuar me titullin “Doctor Honoris Causa” nga universiteti “Kadri Zeka” dhe “Qytetar Nderi” i Komunës së Gjilanit. “Është një nder i madh për mua të marr sot titullin ‘Doctor Honoris Causa’ nga universiteti publik ‘Kadri Zeka’. Por, më shumë se kaq, ky titull është një kujtesë e fuqishme e përgjegjësisë për arsimin dhe për brezat e rinj që vijnë pas nesh. Faleminderit universitetit ‘Kadri Zeka’ për këtë vlerësim!”, ka thënë presidenti

Begaj. Ndërkaq kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me kryesuesin e Kuvendit Komunal Kushtrim Kadriun kanë pritur në takim presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, ku kanë diskutuar për projektet e përbashkëta Kosovë-Shqipëri dhe gjendjen politike në të dyja vendet. Më pas presidenti Begaj u shpall “Qytetar Nderi” i Komunës së Gjilanit. Kryetari i Komunës së Gjilanit Alban Hyseni, tha se ishte kënaqësi e jashtëzakonshme të mirëpresim në Gjilan, presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj. “Pas një takimi ku diskutuam për projektet e përbashkëta Kosovë-Shqipëri,

gjendjen politike në të dyja vendet, patëm nderin e veçantë të dekorojmë Presidentin e Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj, me titullin ‘Qytetar Nderi’ - një mirënjohje për kontributin e tij të çmuar në forcimin e lidhjeve mes Kosovës dhe Shqipërisë”, tha Alban Hyseni. I pari i Gjilanit falënderoi presidentin për përkushtimin në avancimin e marrëdhënieve vëllazërore dhe mbështetjen e vazhdueshme për Kosovën. Nga ana tjetër presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, tha se me emocion, mirënjohje dhe përlësi pranoi titullin “Qytetar Nderi” i Gjilanit, të këtij qyteti në rrugët e të cilit ndihet historia, energjia rinore,

shpresa për të ardhmen. “Ky titull u përket të gjithë shqiptarëve, që në momentet më të vështira të historisë së Kosovës qëndruan pranë dhe krah jush, si pjesë e pandashme e trungut të përbashkët”, tha presidenti Begaj. Ndërsa kryesuesi i Kuvendit Komunal Kushtrim Kadriu, tha se Gjilani ka qenë gjithmonë një komunë që ka nderuar dhe respektuar rolin e madh të Republikës së Shqipërisë në çlirimin dhe ndërtimin e vendit tonë. Sipas tij, presidenti Begaj ka dhënë një kontribut të çmuar në këtë proces dhe ky nderim është një shenjë mirënjohjeje për angazhimin dhe mbështetjen e tij të vazhdueshme.

Gentrit Murseli, këshilltar nga LDK-ja tha se: “Zoti i bekoftë të gjithë ata që vendosin një gur në kalanë e pathyeshme të kombit tonë. Shpallëm Qytetar Nderi të Gjilanit Presidentin e Shqipërisë, Shkëlqesinë e Tij z. Bajram Begaj”. Bujar Nevzati, këshillat nga PDK-ja, tha se është nder të kemi mes nesh, siç është nder për Gjilanin dhe gjithë qytetarët që tani e tutje të të kemi Qytetar Nderi. Nazim Gaguica nga AAK-ja tha se shprehin mirënjohjen dhe krenarinë e thellë për nderimin që po i bëjnë një figure të lartë shtetërore, presidentit të Shqipërisë, Bajram Begaj, duke i dhënë titullin “Qytetar Nderi” i Komunës së Gjilanit.

KRASNIQI: NËSE LV-ja S’MUNDET TA FORMOJË QEVERINË, RADHA ËSHTË E JONA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 PRILL - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë të premten se janë të gatshëm t’u ofrojnë qytetarëve një qeveri tjetër. Ai ka thënë se nëse LV-ja nuk mundet ta formojë qeverinë, radha është e PDK-së me partitë tjera të opozitës. “Siç ju kemi njoftuar, ne kemi një komunikim të vazhdueshëm me partitë opozitare dhe besoj shumë që, duke respektuar rendin kushtetues, në momentin kur një gjë e tillë merr edhe validitetin legal, pas dështimit potencial, po e quaj kështu, të partisë së parë për të formuar qeverinë e re. Ne shumë shpejt jemi të gatshëm t’ua ofrojmë qytetarëve dhe vendit një qeveri tjetër”, ka thënë Krasniqi. Ndërkaq ka thënë se është shumë herët të flitet për postin e presidentit. “I kanë mbetur edhe 11 muaj mandat presidentes aktuale. Nëse



arrihet një marrëveshje e shpejtë për formimin e një qeverie të re, të udhëhequr nga Bedri Hamza, ma merr mendja që në një proces prej dhjetë apo njëmbëdhjetë muajsh do të krijohej një situatë e re”,

është shprehur ai. Krasniqi ka thënë për mediet se është një radhë shumë normale e legjitimitetit që, në rast se i pari dështon, atëherë i dyti merr mandatin. “Presidentja do të duhej, në

rastin e dështimit të z. Kurti si i pari në këto zgjedhje, të na ftojë neve për ta mandatuar kandidatin tonë. Ne e kemi mandatuar Bedri Hamzën. Jam i bindur se ai është përtej një figure partiake; është një figurë

e pranueshme edhe për partitë e tjera politike dhe qytetarët në përgjithësi, pa dallim të votave që kanë dhënë më 9 shkurt. Do të mund të vendosnim interesat e vendit mbi interesat dhe kërkesat partiake që mund të kenë partitë”, ka thënë Krasniqi. Ai ka theksuar se Kushtetuta parasheh që më 15 prill të konstituohet Kuvendi. “Nuk është e thënë që ne patjetër të votojmë, krejt çka presim është që më 15 prill të propozohet kryetari i Kuvendit, dhe ne të propozojmë nënkryetarët. Pse duhet të jetë problemi të votohet kryetari i Kuvendit? Nuk është telashe të bëhen 61 vota. Unë vetëm shpresoj që do të ketë respektim, së pari të vullnetit qytetar, votës së qytetarit, dhe Kushtetutës së Kosovës. Të martën, partia e parë duhet të propozojë kryetarin e Kuvendit dhe kjo është me rëndësi të ndodhë. Në momentin që ndodh kjo, jam i bindur se nuk do të ketë asnjë telashe që të bëhen 61 vota”, ka thënë Krasniqi.



SHTRENJTOHET RRYMA PËR 16 PËR QIND NË KOSOVË, PARALAJMËROHEN PROTESTA TË VAZHDUESHME

Me thirrjet “Asnjë cent më shumë” qytetarë të shumtë kanë protestuar të premten në sheshin “Zahir Pajaziti” duke kundërshtuar shtrenjtimit e rrymës, pak orë pasi Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë e Kosovës (ZRrE) miratoi vendimin për shtrenjtim të rrymës për 16 për qind më shumë. Njëri nga organizatorët e protestës nga grupi “Asnjë cent më shumë”, tha se bordi i ZRrE-së i ka shpërfillur kërkesat e qytetarëve dhe paralajmëroi vazhdimin e protestave. Ai gjithashtu tha se do të dorëzojnë padi ndaj vendimit të ZRrE-së më 14 prill në Gjykatën Themelore në Prishtinë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 PRILL - Një numër i madh i qytetarëve kanë protestuar të premten në Prishtinë kundër shtrenjtimit të rrymës, pak orë pasi rregullatori i energjisë miratoi kërkesat e operatorëve energjetikë për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Zyra e Rregullatorit të Energjisë pas mbledhjes së bordit, ka konfirmuar se çmimi i rrymës është rritur për 16%. “Rritja mesatare e tarifave për të gjitha kategoritë e konsumatorëve bazuar në të Hyrat e Lejuara Maksimale është rreth 16%.

Pjesë e shqyrtimit nga Bordi kanë qenë edhe ankesat e konsumatorëve dhe çështje të tjera të lidhura me funksionimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji”, ka njoftuar ZRrE-ja. Njëri nga organizatorët e protestës nga grupi “Asnjë cent më shumë”, tha se bordi i ZRrE-së i ka shpërfillur kërkesat e qytetarëve dhe paralajmëroi vazhdimin e protestave. “Thirrja jonë e përbashkët sot u shkoi në vesh të shurdhër zyrtarëve të ZRrE-së: Asnjë cent më shumë. Sot në mënyrë arbitrare, në mënyrë jolegjitime dhe në mënyrë të njëanshme, bordi i rregullatorit mori

vendim pa i pyetur dhe pa i marrë parasysh komentet e qytetarëve. Ata nuk e përfaqësojnë popullin”, tha ai. Protesta nisi në mesditë në sheshin Zahir Pajaziti në qendër të qytetit dhe vazhdoi te zyra e rregullatorit të energjisë në lagjen Pejton. Organizatorët paralajmëruan se do të dorëzojnë padi ndaj vendimit të ZRrE-së më 14 prill në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Aktivistët e grupit “Asnjë cent më shumë” bënë një mbishkrim para zyrës së ZRrE-së “KEDS t’i kthehet popullit”. Ndërkaq, protestuesit me brohoritma kërkuan

dorëheqjen e anëtarëve të ZRrE-së. Kjo është protesta e dytë kundër shtrenjtimit të rrymës në vend, pas asaj më 5 prill. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut [KOSTT], Kompania për

Distribuem të Energjisë Elektrike në Kosovë [KEDS] dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike [KESCO] kërkuan ngritjen e çmimit të tarifave të rrymës për shkak të importit të energjisë elektrike.



Bordi i ZRrE-së i miratoi kërkesat e tyre në mbledhjen e së premtes, dhe tha se do të njoftojë për përqindjen e rritjes së çmimit të rrymës në ditët në vijim. Më herët, ZRrE-ja njoftoi se tarifat e reja do të hynin në fuqi më 1 maj.

Rregullatori i energjisë propozoi muajin e kaluar shtrenjtimin e çmimit të energjisë elektrike në vend për rreth 15 për qind, duke argumentuar se rritja e tarifave këtë vit është e domosdoshme, për shkak të uljes së prodhimit të energjisë, rritjes së konsumit dhe varësisë së madhe nga importet me çmime të larta.

Derisa Presidenca e kundërshtoi ngritjen e çmimit të rrymës, Qeveria në detyrë i bëri thirrje ZRrE-së të mos e shtrenjtonte çmimin e rrymës për konsumatorët që shpenzojnë më pak se 800 kilovat në muaj.

Çmimi i tanishëm i rrymës për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë brenda një muaji, është 7.79 centë për kilovat, ndërsa për ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë u llogaritet me çmim prej 14.45 centësh.

Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka shprehur shqetësimin për paralajmërimin për shtrenjtimin e energjisë elektrike 15 për qind.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka theksuar se shtrenjtimi i rrymës do të



ndikojë negativisht te bizneset dhe qytetarët, duke i shtuar vështirësitë ekonomike dhe varfërinë.

Ai vuri në dukje se mbi 1 300 biznese, përfshirë ato me mbi 50 punëtorë, do të detyrohen të blejnë energji elektrike në tregun e hapur, që do të çojë në shtrenjtimin e produkteve dhe shërbimeve.

Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje përmes të deleguarve të tyre në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë Elektrike e rriti çmimin e energjisë elektrike. "Kanë

mashtruar, asgjë s'kanë punuar, tash po godasin qytetarët për të tretën herë përmes faturave të energjisë elektrike. A i ka marrë Vetëvendosje 42 për qind për këtë punë?", ka shkruar Bajrami në "Facebook".

Edhe deputetja e PDK-së, Blerta Deliu, ka thënë se rritja e çmimit të rrymës është vjedhje e hapur ndaj qytetarëve. "Është mundi i përditshëm që po ju vidhet pa mëshirë. Çfarë tjetër duhet të ju marrin? Dinjitetin? Të ardhmen? Kjo padrejtësi duhet ndalur! Asnjë cent më shumë nga djersa e qytetarit!", ka shkruar ajo në "Facebook".



Në ditën kur Zyra e Rregullatorit të Energjisë mori vendim për shtrenjtim të çmimit të energjisë, drejtori i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Kushtrim Ahmeti tha se rritja e çmimit të energjisë elektrike në këtë kohë rrezikon vendet e punës. "Nga fillimi kemi qenë kundër, biznesi dhe qytetarët nuk duhet të paguajnë dështimin. Kemi gati se çdo ditë njoftime nga KESCO se po rritet kërkesa për import të energjisë elektrike. Për katër vjet institucionet kanë dështuar të sjellin investime të jashtme", ka deklaruar ai.

Në konferencën për medie, Ahmeti tha se bizneset vendore janë në situatë të vështirë. Shtrenjtimin e rrymës e ka kundërshtuar disa herë edhe KMDLNj, duke theksuar se rritja e çmimit të rrymës do të prodhojë efekte zinxhirore, duke rritur çmimet e artikujve të domosdoshëm si dhe të gjitha shërbimeve. "Qytetarët e Kosovës nuk duhet t'i besojnë ZRrE-së e as qeverisë në detyrë, sepse në mbrojtje të interesave të operatorëve, kanë dështuar të mbrojnë interesat e qytetarëve", ka theksuar KMDLNj.

HOTI: LDK-JA DUHET TË RIORGANIZOHET PËRMES NJË PROCESI ZGJEDHOR

PRISHTINË, 11 PRILL - Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, nuk është shprehur i kënaqur me rezultatin e LDK-së në zgjedhjet e 9 shkurtit.

Për këtë rezultat, ai ka kërkuar reflektim dhe përgjegjësi politike nga organet partiake. Në një intervistë për gazetën "Nacionale", ish-kryeministri i Kosovës ka vlerësuar se reflektimi duhet të realizohet përmes një riorganizimi të LDK-së.

Ai ka treguar se ky riorganizim mund të bëhet vetëm përmes një procesi zgjedhor të brendshëm.

Sipas tij, ky proces duhet të jetë gjithëpërfshirës, transparent, statutar dhe vizionar.

Deputeti Hoti ka bërë me dije se LDK-ja duhet të veprojë ashti siç ka bërë në vitin 2021, pas

zgjedhjet të shkurtit.

Duke folur për pakënaqësitë në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve të fundit, ai ka thënë se kritikën e tij nuk duhet të shihen si ambicie të tij personale.

Në këtë intervistë, ai ka folur edhe për kritikën e zyrtarëve të LDK-së ndaj tij dhe qëndrimet e kësaj partie në raport me IV-në dhe partitë opozitare. "Pas katër vitesh në opozitë, ky rezultat nuk është i kënaqshëm. Por ky është vullneti i qytetarëve për LDK-në dhe ne duhet ta pranojmë atë. Ne tani duhet të debatojmë intenzivisht për shkaqe që sollën këtë rezultat dhe për rrugën tonë përpara, siç bëmë në vitin 2021", ka thënë Hoti, duke shtuar se në çdo garë politike, përgjegjësia për rezultatin zgjedhor nis nga



zyrtari i parë i LDK-së në kontakt me qytetarë, që është anëtar i Kryesisë së Nëndegës në lagje të qyteteve e në fshatra, e përfundon tek kryetari i LDK-së si përgjegjësi kryesor. "Ne i kemi dhënë autorizime të plota Kryetarit të LDK-së për të organizuar partinë që nga viti 2021 e këndej. I kemi dhënë besimin dhe mbështetjen e plotë për vendimet e tij në

funkcion të përgatitjeve për këto zgjedhje. Kur jepet besimi i plotë, kërkohet edhe përgjegjësi e plotë", ka thënë Hoti.

Ai ka theksuar se rezultati zgjedhor na ka treguar se ndryshimet që janë bërë në LDK në 2021, pastaj zgjedhjet partiake në 2023, opozita katërvjeçare në Kuvendin e Kosovës, si dhe programi e fushata zgjedhore e këtij viti nuk i kanë bindur qytetarët për t'ua kthyer besimin. "Ne tani e ndjejmë përgjegjësinë për këtë rezultat zgjedhor, dhe natyrshëm kërkojmë debat veprim, siç kemi vepruar edhe në vitin 2021. Deklarimi që kam bërë para disa jave ka pasur këtë qëllim - reflektim dhe dakordim i përbashkët për rrugën përpara të LDK-së. Kemi diskutuar në Kryesi të LDK-së, kemi takuar

aktivistë të shumtë që janë të dëshpëruar me rezultatin dhe të dëshpëruar me disa vendime që kemi marrë", ka thënë ai.

Hoti ka thënë se qëndrimin që ka pasur publik e ka prezantuar në terma të përgjithshëm së pari në Kryesinë e LDK-së. "Unë insistoja dhe angazhohem që të punojmë së bashku për tu riorganizuar si parti, duke filluar nga nëndega e deri tek lidhësi i partisë. E kam bërë të qartë në Kryesinë e LDK-së se të gjithë e kemi bërë maksimumin, por rezultati zgjedhor na ka treguar se përpjekjet tona nuk kanë qenë të mjaftueshme për të bindur qytetarët. Prandaj, nuk ka rrugë tjetër përpos reflektim dhe riorganizim të strukturave partiake në të gjitha nivelet", ka thënë Hoti.

ABDIXHIKU: NJË KRYETAR I KUVENDIT QË NUK I KA 61 VOTA, NUK DUHET TË JETË FARE NË ATË POZITË

PRISHTINË, 11 PRILL - Pas regjistrimit si deputet i Kuvendit të Kosovës, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku në një prononcim për medie tha se e njohin të drejtën e plotë të partisë së parë që të provojë të bëj shumicën.

Abdixhiku tha se nëse nuk e bën partia e parë, atëherë janë afatet Kushtetuese që partitë tjera të dëshmojnë para presidencës së mund ta bëjnë shumicën për formimin e Qeverisë. "E njohim të drejtën e plotë të partisë së

parë që të provojë të bëj shumicën, nëse nuk e bën pas 15 ditëve Kushtetuta e Kosovës është shumë e qartë i jep të drejtën secilës parti që dëshmon para presidencës që mund të bëj shumicën, ka bërë një gjë të tillë. Nuk kemi mbërrirë në atë pikë. Do të jem po aq transparentë para jush edhe për këtë çështje kur të mbërrijmë atje", ka thënë ai.

Tutje i pari i LDK-së tha se nëse një kryetar i Kuvendi nuk i ka 61 vota atëherë nuk duhet të jetë fare në atë pozitë. "Një kryetar i

Kuvendit që nuk i ka 61 vota për vete nuk duhet të jetë kryetar fare. Pra minimalisht duhet t'i ketë 61 vota. Qëndrimet e LDK-së i keni dëgjuar tashmë janë të njëjta si para fushatës, gjatë fushatës dhe pas fushatës. Proceduralisht besoj e dini që më 15 prill do të bëhet betimi, më pas bëhet propozimi i kryetarit të Kuvendit, konstituohet Kuvendi pas zgjedhjes së kryetarit dhe kryesisë së Kuvendit", ka thënë Abdixhiku.



INTEGRIMI I KOSOVËS NË BE DHE HARMONIZIMI I STANDARDEVE KUSHTETUESE

Shkruan: Nijazi HALILI

Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian është një proces kompleks dhe i kërkuar për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, stabilitet politik dhe një shoqëri demokratike. Ky proces, i cili kërkon përputhje të plotë me standardet dhe rregullat evropiane, ka një rëndësi të veçantë në kuadër të zhvillimit të strukturave kushtetuese dhe legislative të shtetit. Një nga elementët kyç për këtë integrim është harmonizimi i standardeve kushtetuese, për të siguruar që Kosova të jetë në përputhje me vlerat dhe parimet themelore të Bashkimit Evropian.

Kushtetuta e Kosovës dhe lidhja me BE-në; Kushtetuta e Kosovës, e miratuar më 2008, paraqet kornizën juridike për ndërtimin e institucioneve demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Për të përmbushur aspiratat e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Kosova duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me atë të BE-së, përfshirë rregullat dhe normat



kushtetuese. Ky harmonizim është një proces i vazhdueshëm, që përfshin rishikimin dhe përmirësimin e institucioneve të shtetit për të garantuar sundimin e ligjit, transparencën dhe të drejtat e qytetarëve.

Harmonizimi i standardeve kushtetuese; Një nga prioritetet kryesore për integrimin evropian të Kosovës është

harmonizimi i standardeve kushtetuese me normat dhe praktikatat e BE-së. Ky proces ka të bëjë me përputhjen e strukturave të pushtetit dhe ndarjes së kompetencave mes institucioneve, si dhe me forcimin e pavarësisë së gjyqësorit. Për më tepër, Kosova duhet të sigurojë që Kushtetuta e saj të garantojë barazinë dhe të drejtat e

pakicave etnike, në përputhje me vlerat e diversitetit dhe pluralizmit që BE-ja i promovon. Ky harmonizim është i domosdoshëm për të krijuar një sistem të drejtësisë që është i pavarur dhe i drejtë, dhe që siguron llogaridhënie dhe transparencë.

Sfida të brendshme dhe ndërkombëtare; Harmonizimi i standardeve kushtetuese nuk është pa sfida. Në nivel të brendshëm, Kosova përballlet me sfida të natyrshme në forcimin e institucioneve të saj dhe garantimin e funksionimit të plotë të shtetit ligjor. Për më tepër, si një shtet shumëetnik, Kosova duhet të sigurojë që Kushtetuta e saj të mbrojë të drejtat e të gjitha grupeve etnike dhe të sigurojë integrimin e komunitetit serb dhe pakicave të tjera në jetën politike dhe shoqërore të vendit. Në nivel ndërkombëtar, marrëdhëniet me Serbinë dhe procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve janë një sfidë që vazhdon të ndikojë në përmbushjen e kushteve për anëtarësimin në BE.

Reformat dhe integrimi i drejtësisë; Një nga shtyllat e

rëndësishme të procesit të integritetit është reforma e sistemit të drejtësisë. Pavarësia e gjyqësorit dhe lufta kundër korrupsionit janë të domosdoshme për të garantuar se sistemi ligjor funksionon në përputhje me parimet evropiane. Kosova ka arritur përparime në këtë drejtim, por ende ka nevojë për përmirësime të mëtejshme në forcimin e institucioneve të drejtësisë, duke u siguruar që ato të jenë të lira nga ndikimet politike dhe të veprojnë në interesin e qytetarëve.

Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian është një proces që kërkon angazhim të vazhdueshëm për të siguruar harmonizimin e standardeve kushtetuese me ato evropiane. Ky harmonizim është thelbësor për forcimin e institucioneve demokratike, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për ndërtimin e një shteti ligjor të qëndrueshëm. Ndërsa Kosova përballlet me sfida të ndryshme, përpjekjet për përmbushjen e kërkesave të BE-së do të sigurojnë një të ardhme më të sigurt dhe më të ndritshme për qytetarët e saj dhe për të gjithë rajonin.

ÇMIMET E KONSUMIT 2.9% MË TË SHTRENJTA SESA NË TË NJËJTËN PERIUDHË TË VITIT TË KALUAR

PRISHTINË, 11 PRILL - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin mars 2025, viti bazë 2015=100. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,9% në muajin mars 2025, krahasuar me muajin mars 2024. Inflacioni mujor ishte 0,8% në muajin mars 2025.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,9% në muajin mars 2025, krahasuar me muajin mars 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: kafe, çaj dhe kakao (17,1%); perime (8,7%); mish (8,3%); shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (7,6%); qumësht, djathë dhe vezë (7,1%); pemë (6,7%); pije alkoolike (6,3%); gazeta, libra dhe materiale për zyra (6,2%); shërbime hoteliere (5,8%); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (5,4%); këpucë

(5,4%); shërbime financiare (5,2%); shërbime ambulantore (5,2%); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (4,8%); kujdes personal (4,3%); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (3,7%); mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (3,2%); duhan (2,9%); sheqer, reçel, mjaltë, çokollatë dhe ëmbëlsira (2,4%); veshje (2,4%); bukë dhe drithëra (2,1%); pajisje shtëpiake (1,9%); shërbime për transport (1,8%); qelqurina, takëme dhe mjete të kuzhinës (1,3%); dhe gjëra dhe pajisje të tjera rekreative, kopshte dhe manare (0,9%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 3,5 për qind në IHÇK.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (-6,7%); si dhe karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (-5,0%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0,6 për qind) në IHÇK.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,8% në



muajin mars 2025, krahasuar me muajin shkurt 2025. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: perime (5,3%); pemë (4,5%); shërbime ambulantore (3,3%); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (2,7%); këpucë (2,6%);

shërbime hoteliere (2,5%); kafe, çaj dhe kakao (2,4%); mish (2,3%); pije alkoolike (1,8%); kujdes personal (1,6%); qumësht, djathë dhe vezë (1,4%); shërbime për transport (1,3%); veshje (1,2%); gjëra dhe pajisje të tjera rekreative, kopshte dhe manare (1,0%); bukë dhe drithëra (0,5%), me një ndikim të përbashkët të

këtyre nëngrupeve prej 1,0 për qind në IHÇK.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: energji elektrike (-4,7%) dhe karburante e lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (-0,9%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0,2 për qind) në IHÇK.

PDK-ja regjistron zyrtarisht Grupin Parlamentar në legjislaturën e re të Kuvendit të Kosovës

PRISHTINË, 11 PRILL - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka regjistruar të premtën zyrtarisht Grupin e saj Parlamentar në legjislaturën e nëntë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura më 9 shkurt 2025. Me 24 deputetë të zgjedhur, Partia Demokratike e Kosovës do të përfaqësojë me përgjegjësi qytetarët në Kuvend, duke promovuar politika

zhvillimore, integruese dhe të orientuara drejt së ardhmes.

LISTA E DEPUTETËVE TË REGJISTRUAR NGA RADHËT E PDK-SË ËSHTË SI MË POSHTË:

1. Memli Krasniqi
2. Uran Ismaili
3. Vlora Çitaku
4. Sala Jashari
5. Enver Hoxhaj
6. Përparim Gruda
7. Ganimete Musliu
8. Nait Hasani

9. Jakup Nura
10. Rrahman Rama
11. Artan Behrami
12. Mërgim Lushtaku
13. Elmi Reçica
14. Ferat Shala
15. Blerta Deliu-Kodra
16. Fadil Demaku
17. Altin Krasniqi
18. Xhevahir Geci
19. Abelard Tahiri
20. Ariana Musliu-Shoshi
21. Rashit Qalaj
22. Eliza Hoxha
23. Arbnore Salihu
24. Kosovare Murseli



OSMANI TAKON ERDOGANIN: TURQIA MBETET PARTNERE E RËNDËSISHME E KOSOVËS



PRISHTINË, 11 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka lartësuar të premtën marrëdhëniet e vendit të saj me Turqinë, pas një takimi me presidentin turk, Recep Tayyip Erdogan, në Forumin e Diplomacisë në Antalia. Në një postim në "Facebook", Osmani tha se Turqia është dhe do të mbetet partnere e rëndësishme e Kosovës për paqen, sigurinë dhe zhvillimin rajonal. "Marrëdhëniet tona janë më shumë se miqësi, janë një partneritet i ndërtuar mbi besim, respekt dhe vizion të përbashkët për të ardhmen", tha ajo. Të premtën në Antalia ka nisur

edicioni i katërt i Forumit dyditor të Diplomacisë, i organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Turqisë, nën patronazhin e Erdoganit. Forumi këtë vit trajton temën "Rikthimi i Diplomacisë në një Botë të Fragmentuar", e cila pasqyron nevojën urgjente që diplomacia të vihet në pah si forcë stabilizuese, mes rritjes së tensioneve globale. Osmani e përshkroi Erdoganin si "lider që i qëndroi Kosovës pranë gjithmonë, në çdo sfidë e në çdo sukses". "Një mik i dëshmuar i Kosovës, një zë i fuqishëm për të drejtën tonë, dhe një shtyllë e fortë mbështetjeje në çdo etapë

të shtetndërtimit tonë", tha ajo. Turqia është një prej shteteve me praninë më të madhe të investimeve direkte në Kosovë. Ajo gjithashtu është një ndër shtetet e para që ka njohur pavarësinë e Kosovës në shkurt të vitit 2008. Dhjetorin e kaluar, Qeveria e Kosovës e nënshkroi një marrëveshje me prodhuesin shtetëror turk të industrisë së mbrojtjes, Makine ve Kimya Endüstrisi, për themelimin e një fabrike të municioneve në Kosovë. Ndërsa, në vitin 2023 Kosova bleu dronë Bayraktar TB-2 nga Turqia.

HYN NË FUQI MARRËVESHJA PËR NJOHJEN E PATENTSHOFERËVE NDËRMJET KOSOVËS DHE EMIRATEVE



Prishtinë, 11 prill- Ministria e Punëve të Jashtme e Emirateve të Bashkuara Arabe ka njoftuar përmes një Note Verbale, të dërguar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Abu Dhabi, se ka hyrë në fuqi marrëveshja për njohjen reciproke të patentshoferëve ndërmjet dy vendeve. Kjo marrëveshje u mundëson qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe Emirateve të Bashkuara Arabe që të konvertojnë patentë shoferët e tyre pa pasur nevojë t'iu nënshtrohen provimeve teorike apo praktike në vendin pritës. Ajo përfaqëson një hap të

rëndësishëm drejt lehtësimit të lëvizjes dhe integritetit të qytetarëve të të dyja vendeve. Ky zhvillim është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve përkatëse të të dyja shteteve dhe dëshmon për përkushtimin e ndërsjellë në forcimin dhe thellimin e marrëdhënieve bilaterale. Marrëveshja është nënshkruar më 4 dhjetor 2024 në Abu Dhabi, nga ministri i Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, Xhelal Sveçla, dhe ministri i Punëve të Brendshme i Emirateve të Bashkuara Arabe, H.H. Sheikh Saif bin Zayed Al Nahyan.

Kjo është marrëveshja e dytë me rëndësi të veçantë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, pas marrëveshjes së janarit 2024 që mundësoi heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës, duke forcuar më tej lidhjet me një shtet me ndikim të rëndësishëm politik dhe ekonomik në rajon dhe në skenën globale. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Republikës së Kosovës shpreh mirënjohjen dhe konsideratat më të larta për autoritetet e Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm dhe konstruktiv.

Bëhen homazhe para bustit të komandantit Agim Ramadani, në 26-vjetorin e rënies

GJILAN, 11 PRILL - Në përvjetorin e 26 të rënies heroike të komandantit Agim Ramadani, kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me nënkryetaren Leonora Morina-Bunjaku, drejtorë e zyrtarë konunalë bënë homazhe para bustit të tij, duke nderuar sakrificën dhe guximin e jashtëzakonshëm që ai dha për lirinë e Kosovës. Kryetari u Komunës së Gjilanit, tha se në përvjetorin e

rënies heroike të komandantit Agim Ramadani, bënë homazhe para bustit të tij, duke nderuar sakrificën dhe guximin e jashtëzakonshëm që ai dha për lirinë e Kosovës. "Komandant Katana, me vizionin dhe vendosmërinë e tij të hekurt, ishte një udhëheqës që i dha gjithçka atdheut, duke u bërë një figurë që do të mbetet përherë në zemrat dhe mendjet e shqiptarëve", tha Alban

Hyseni. I pari i Gjilanit, theksoi se liria dhe pavarësia që gëzojmë sot janë rezultat i sakrificës së tij të paçmueshme. Emri i tij do të mbetet i gjallë përjetësisht në Gjilan dhe të gjithë Kosovën, duke simbolizuar luftën dhe fljimin për atdheun. "Lavdi e përjetshme për komandantin Agim Ramadani dhe të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë e Kosovës", tha kryetari Alban Hyseni.



Çmime të ulëta, tarifa të larta: Si ndikon në tregun kosovar lufta tregtare ShBA-Kinë?

PRISHTINË, 11 PRILL - Telefona të mençur, kompjuterë, vegla pune, veshmbathje... Këto janë vetëm disa nga produktet me origjinë nga Kina që zënë një vend të rëndësishëm në tregun e Kosovës. Së fundi, Shtetet e Bashkuara vendosën tarifa në mallrat e importuara nga shumica e vendeve të botës. Mallrave nga Kina iu vendos një tarifë masive prej 104 për qind. Përderisa profesori i ekonomisë, Mejdi Bektashi, thotë se kjo luftë tregtare mes ShBA-së dhe Kinës mund t'i detyrojë kompanitë kosovare që t'i zëvendësojnë produktet kineze me produkte të tjera, pronari i kompanisë Elkos Group, Ramiz Kelmendi, thotë se ai do të vazhdojë të importojë nga Kina, madje pret të ketë çmime më të ulëta.

Sa janë të rëndësishme mallrat nga Kina për tregun në Kosovë?

Megjithëse Kina vazhdon të mos e njohë pavarësinë e Kosovës, kjo gjë nuk ka penguar bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar mes dy vendeve. Të dhënat zyrtare tregojnë se Kina është ndër importueset kryesore në tregun kosovar, duke u renditur në vendin e tretë për nga volumi i mallrave, pas Gjermanisë dhe Turqisë. Vetëm gjatë vitit të kaluar, nga vlera e përgjithshme e importit prej 6.3 miliardë eurosh, sipas Doganës së Kosovës, mbi 748 milionë euro - ose mbi 12 për qind kanë qenë produkte kineze. Në anën tjetër, eksportet e Kosovës në Kinë kanë qenë të vogla, me vlerë prej 426 mijë eurosh, ose 0.1 për qind të vlerës së përgjithshme të eksportit, që është rreth një miliard euro. Produktet e eksportuara përfshijnë xeherore, koncentrat kromi, makina për kositje e fustane. Në mesin e kompanive importuese është edhe kompania Elkos Group, në kuadër të së cilës funksionon



dhe zinxhiri i supermarketeve, ETC. Ramiz Kelmendi, pronari i këtij zinxhiri tregtar, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se kompania e tij për çdo vit blen produkte deri në 12 milionë euro nga Kina. Sipas tij, arsyeja e bashkëpunimit është që shumë produkte prodhohen vetëm në Kinë dhe, për shkak të fuqisë së lirë punëtore atje, çmimi është më i favorshëm për tregun e Kosovës. "Nëse do prodhoheshin në Evropë apo Amerikë, sigurisht që ato do ishin prioritetet tona. Por, nëse dikush nga Bashkimi Evropian importon nga Kina, i monton produktet dhe i eksporton si të vetat, ajo i bie që ne po paguajmë montimin. Kështu që më leverdi kemi t'i blejmë direkt në Kinë, dhe punëtorët tanë këtu e bëjnë montimin, në këtë mënyrë edhe hapim vende të reja të punës edhe i blejmë më lirë", shprehet ai.

Si do ta ndikojnë tarifat e ShBA-së ndaj Kinës tregun në Kosovë?

Më 2 prill, presidenti i ShBA-së, Donald Trump, vendosi tarifa prej 34 për qind ndaj mallrave kineze, si pjesë e një vendimi më të gjerë, ku vendosi tarifa

ndaj shumicës së partnerëve tregtarë. Kosovës iu vendos tarifa bazë prej 10 për qind. Dy ditë më vonë, më 4 prill, Kina u kundërpërgjigj me tarifa të njëjta ndaj mallrave amerikane. Katër ditë më vonë, ShBA-ja njoftoi për tarifa shtesë ndaj Kinës, duke arritur në 104 për qind dhe duke i kërkuar Kinës që të tërheqë masat e saj. Më 9 prill - kur tarifat amerikane ndaj Kinës dhe vendeve të tjera nisën të zbatohen - Pekini njoftoi për rritjen e tarifës ndaj mallrave amerikane nga 34 në 84 për qind. Këto zhvillime shënojnë një përshkallëzim të luftës tregtare midis dy ekonomive më të mëdha në botë. Kjo përplasje do të ketë pasojë jo vetëm për ShBA-në dhe Kinën, por edhe për gjithë tregun global, përfshirë dhe Kosovën, thotë profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejdi Bektashi. Marrë parasysh se Kosova vazhdon të jetë e varur nga mallrat e importuara, thotë ai, vendi do ta ketë të vështirë të shmangë pasojat e këtyre tarifave. Bektashi shprehet se tarifat e reja do të shkaktojnë një valë të re inflacioni, e cila do të ndikojë jo vetëm në ShBA, por edhe në Evropë. "Nga zbatimi i

tarifave, barra do të bjerë në fund të zinxhirit, te konsumatorët. Konsumatorët në të gjithë botën, përfshirë ata në Kosovë, do të blejnë produkte kineze deri në 40 për qind më shtrenjtë sesa paguajnë aktualisht", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë". Për t'i shmangur këto çmime, Bektashi thotë se kompanitë kosovare duhet të orientohen drejt tregjeve të tjera të Bashkimit Evropian. "Në këtë kontekst, tregjet alternative do të gjenden më lehtë dhe do të ofrojnë produkte me cilësi më të lartë, por gjithashtu me çmime më të larta. Humbësi më i madh, nga këto tarifa do të jetë Kina, si dhe disa shtete aziatike me zhvillim të shpejtë ekonomik, si India dhe Vietnam", thekson ai. Ndërkohë, Ramiz Kelmendi nga Elkos Group, i cili më parë ka pasur edhe pozitën e zëvendëskryeministrit në Qeverinë e Kosovës, beson se kompania e tij do vazhdojë të importojë nga Kina edhe pas vendosjes së tarifave nga

ShBA-ja. Ai beson se tarifat e reja ndaj Kinës do të ndikojnë në uljen e çmimeve të produkteve. "Pasi Kina eksporton shumë në tregun e SHBA-së, pas ndikimit të tarifës do të zvogëlohet sasia e produkteve për këtë treg dhe produktet do të orientohen në tregje të tjera. Kina nuk do ta ndalë prodhimin, por do të rritet konkurrenca dhe kjo do ta sjellë uljen e çmimeve për tregjet e tjera", shprehet Kelmendi. Për dallim nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Kina nuk ka realizuar investime kapitale në Kosovë. Bashkëpunimi mes dy vendeve mbetet në nivelin e importit dhe eksportit të mallrave.

Marrëdhëniet diplomatike mes Kosovës dhe Kinës

Kina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, por respekton, siç thotë, integritetin territorial të Serbisë, e cila, me Kushtetutë, Kosovën e trajton ende si pjesë të territorit të saj. Për këtë arsye, dy shtetet nuk kanë marrëdhënie diplomatike, por Kina ka një zyrë ndërlidhëse në Kosovë, që funksionon nën Ambasadën kineze në Beograd. Nëse qytetarët e Kosovës duan ta vizitojnë Kinën, ata duhet të pajisen me vizë, të cilën mund ta kërkojnë në Zyrën Ndërlidhëse në Prishtinë. Viza shqyrtohet në Ambasadën e Kinës në Beograd. Ngjashëm edhe qytetarët kinezë, përveç atyre me pasaporta diplomatike, që dëshirojnë ta vizitojnë Kosovën duhet të kenë vizë dhe mund ta marrin atë në ambasadat e Kosovës në Shqipëri ose Turqi.

Eksporti dhe importi Kosovë - Kinë

Përderisa Kina është ndër vendet nga të cilat Kosova importon më së shumti mallra, eksporti i Kosovës në Kinë nuk është shumë domethënës. Në tre vjetët e fundit, vlera e mallrave të eksportuara në Kinë ka qenë më pak se një milion euro.

Dollari amerikan bie në nivelin më të ulët ndaj euros që nga viti 2022

Uashington, 11 prill- Dollari amerikan ra në nivelin më të ulët ndaj euros në mbi tre vjet, si pasojë e përshkallëzimit të mëtejshëm të tensioneve tregtare ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës. Konflikti në rritje mes dy ekonomive më të mëdha në botë ka krijuar pasiguri në tregjet financiare globale, duke shtuar trysninë mbi monedhën amerikane dhe duke nxitur investitorët të largohen nga asetet e lidhura me dollarin. Rreth orës 9 të mëngjesit me orën e

Mbretërisë së Bashkuar, 1 euro këmbëhej me 1.14 dollarë amerikanë - niveli më i ulët i dollarit kundrejt monedhës evropiane që nga shkurti i vitit 2022. Ky zhvlerësim pasqyron rënien e besimit të tregjeve në qëndrueshmërinë afatshkurtër të ekonomisë amerikane, në kushtet kur barrierat tregtare dhe tarifat shtesë po ndikojnë negativisht në rrjedhën e shkëmbimeve ndërkombëtare dhe në perspektivën e rritjes ekonomike. Ndërkohë, indeksi i dollarit amerikan - një tregues që mat performancën e dollarit ndaj

një shporte prej disa prej monedhave kryesore ndërkombëtare, përfshirë euron, jenin japonez dhe funten britanike - kishte rënë me 1.3 për qind në të njëjtën periudhë kohore. Dobësimi i indeksit tregor një rënie të përgjithshme të fuqisë së dollarit në tregjet globale të këmbimit valutor, duke reflektuar shqetësimet e investitorëve për ndikimin ekonomik të mosmarrëveshjeve të zgjatura tregtare dhe pasojat e tyre potenciale në tregtinë botërore dhe stabilitetin financiar.



DILEMA E TRUMPIT PËR PROGRAMIN BËRTHAMOR TË IRANIT: TA VERIFIKOJË APO TA SHKATËRROJË?



Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i habiti gati të gjithë kur njoftoi në Zyrën Ovale – gjatë një takimi me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu – se bisedime të drejtpërdrejta të nivelit të lartë për programin bërthamor të Iranit, janë caktuar për 12 prill në Oman.

Nuk është e qartë nëse Irani donte ta mbante të fshehtë këtë, por ministri i Jashtëm Abbas Araqxi e ndjeu shumë të nevojshme të thoshte në pikë të natës, me kohën në Teheran, se bisedimet do të jetë të tërthorta, e kundërta e asaj që e tha Trumpi, shkruan REL.

Pavarësisht formatit, të dyja palët e kanë paraqitur këtë si takim eksplorues për të kuptuar nëse bisedimet mund të zhvillohen.

Por, brenda titujve fshihet një debat më i thellë strategjik: Çfarë duan të bëjnë saktësisht Shtetet e Bashkuara me programin bërthamor të Iranit - ta mbikëqyrin rreptë apo ta shkatërrojnë plotësisht?

Trump ka qenë i qartë për qëllimin përfundimtar të Uashingtonit: Irani nuk duhet të lejohet kurrë të ketë ndonjë armë bërthamore. Ajo që ai nuk e ka thënë në mënyrë të prerë është nëse kjo nënkupton vendosjen e kufizimeve për programin bërthamor të Iranit, apo shkatërrimin e tij tërësisht.

Në vend të tij kanë folur anëtarët e lartë të administratës së tij, por ata kanë dërguar mesazhe kundërtëse.

Steve Witkoff, i dërguari i Trumpit për Lindjen e Mesme, i cili do ta udhëheqë delegacionin amerikan në bisedimet në Oman, tha muajin e kaluar se Uashingtoni dëshiron ta krijojë “një program verifikues, në mënyrë që askush të mos shqetësohet për armët e mundshme që dalin nga materiali bërthamor i Iranit”.

Kjo nënkuptonte se Shtetet e Bashkuara duan ta kufizojnë pasurimin e uraniumit dhe ta vendosin një mekanizëm mbikëqyrës për të garantuar se programi bërthamor i Iranit mbetet paqësor – për çfarë Irani pretendon se ka qenë gjithmonë qëllimi i tij.

Megjithatë, këshilltari për sigurinë kombëtare, Mike Waltz, dha një mesazh ndryshe pak ditë më vonë, duke theksuar se administrata kërkon “çmontim të plotë”, dhe shtoi: “Irani duhet të heqë dorë nga programi i tij në një mënyrë që e shihet e gjithë bota”.

Cili duhet të jetë synimi i SHBA-së?

Mbështetësit e shkatërrimit të plotë të programit bërthamor të Iranit thonë se kjo është mënyra e vetme e sigurt për të garantuar se Irani nuk do të zotërojë kurrë armë bërthamore.

Behnam Taleblu, drejtor i programit për Iranin në Fondacionin për Mbrojtjen e Demokracive (FDD), me seli në Uashington, argumenton se

Trump nuk duhet të merret me kontrollin e armëve.

“Në vend kufizimit, Irani duhet të detyrohet ta shkatërrojë tërësisht programin bërthamor”, tha Taleblu për Radion Evropa e Lirë (REL).

Ai e pranoi se shkatërrimi i tij është veprim “me rrezik të lartë”, por argumentoi se është i arritshëm dhe i domosdoshëm, përmes trysnisë, si rritja e sanksioneve dhe zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta ushtarake me Izraelin.

Më 9 prill, Departamenti amerikan i Thesarit vendosi sanksione ndaj pesë entiteteve dhe një individi në Iran për mbështetjen e tyre për programin bërthamor, përfshirë edhe Organizatën për Energji Atomike të Iranit (AEOI).

Dhe, nëse bisedimet janë të pafrytshme, Taleblu tha se Trumpi duhet të jetë i gatshëm të largohet nga to.

“Republika Islamike do ta mendojë përnjëmend dorëzimin vetëm nëse e di që Amerika ka mundësi të vërtetë për t’u larguar nga bisedimet”, shtoi ai.

Një mbështetës i madh i shkatërrimit të plotë të programit bërthamor iranian është Netanyahu, i cili ka hedhur idenë e një “marrëveshjeje në stilin e Libisë,” një ide që Teherani e ka kundërshtuar kamotshëm.

Të tjerë argumentojnë se çdo kërkesë për shkatërrimin e plotë të programit do të vlerësohej në Teheran si vetëvrasje politike.

“Kërkesat e SHBA-së për

shkatërrimin e plotë, ose një marrëveshje ‘në stilin e Libisë’, që përfshin prishjen e të gjithë programit bërthamor iranian, do të ishin të papranueshme për Teheranin”, tha Gregory Brew, analist për Iranin në Eurasia Group, me seli në Nju Jork.

Ai argumentoi se vendosja e një skeme verifikimi për të mbajtur nën kontroll programin bërthamor të Iranit “do të ofronte, të paktën, një bazë për diskutime të mëtejshme”. Por, nëse Uashingtoni ngul këmbë për të rrënuar plotësisht programin bërthamor të Iranit, “bisedimet do të përfundojnë shpejt dhe rreziku për përshkallëzim ushtarak do të rritet”, shtoi Brew.

A është Irani i gatshëm të rrezikojë shkuarjen në luftë?

Marrëveshja bërthamore e vitit 2015, nga e cila Trump u tërhoq në vitin 2018, skadon zyrtarisht në tetor. Me përfundimin e saj, Këshilli i Sigurimit i OKB-së do ta humbasë fuqinë për të rivendosur sanksione ndaj Iranit. Pra, Përfundimit po i soset si koha, ashtu edhe me durimi.

Trump e ka paralajmëruar Iranin se do ta bombardojë, nëse nuk arrihet marrëveshje.

Franca, një tjetër anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe nënshkruese e marrëveshjes së 2015-ës, ka shprehur shqetësimin se mungesa e një

marrëveshjeje të re do ta bëjë përplasjen ushtarake “pothuajse të pashmangshme”.

Shtetet e Bashkuara kanë shtuar ndjeshëm praninë e tyre ushtarake në rajon. Prej javësh ato kanë nisur sulme ajrore kundër rebelëve Huthi të mbështetur nga Irani, duke përdorur armatimin më të sofistikuar, kundër një grupi që as nuk ka forca ajrore.

“Këto dislokime i ofrojnë SHBA-së kërcënim të besueshëm ushtarak, i cili mund të përdoret për ta rritur trysinë mbi Iranin”, tha Brew.

“SHBA-ja po dërgon sinjale të qarta se është e gatshme për përshkallëzim, nëse bisedimet dështojnë, ose nëse Irani e përparon programin drejt armatimit”, shtoi ai.

Rreziqet për regjimin janë shumë të larta, theksoi ai.

Por, Taleblu beson se Irani është në thelb i kujdesshëm ndaj rreziqeve dhe nuk do të dëshirojë përballje ushtarake.

“Ka raste në histori – edhe pse të rralla – ku regjimi është tërhequr dukshëm nga një synim sigurie për të cilin kishte investuar shumë kapital”, tha ai.

“Kur Teherani ka ndier forcë dhe vendosmëri për shtimin e ndëshkimeve dhe imponimin e kostove me kalimin e kohës, që mund të kërcënojnë seriozisht regjimin, ai është tërhequr”, sipas tij.

Tani do të ketë diplomaci në Oman. Koha po soset. Pyetja është: kush do të tërhiqet i pari? / REL



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Në fundjavë duelet e dyta të ‘play-off’-it

GJAKOVË, 11 PRILL - Fundjava sjell duelet e dyta çerekfinale të “play-off”-it në ProCredit Superligën e Kosovës në basketboll. Të shtunën në Gjakovë pritet përballje e zjarrtë në një atmosferë elektrizuese ndërmjet Vëllaznimit dhe Sigal

Prishtinës. “Bardhekaltrit” fituan ndeshjen e parë 71:69, që u vendos në sekondat e fundit. “Kuqezinjtë” duan të barazojnë serinë çerekfinale, ndërsa prishtinasit me fitore kalojnë në gjysmëfinale. Në Pejë, po ashtu pritet një sfidë mjaft interesante ndërmjet

Pejës dhe Golden Eagle Yllit. Të dy skuadrat “verdhezi” luajnë vetëm për fitore, derisa kërkojnë të rikthejnë titullin në qytetet e tyre. Ndeshja e parë në Therandë përfundoi me fitoren e pejanëve 71:77. Kjo ishte humbja e parë për

therandasit, pas gjashtë fitoreve radhazi në elitë. Skuadra që shënon dy fitore kualifikohet në gjysmëfinale. E, rruga drejt titullit është e gjatë, pasi për të depërtuar në finale duhen tri fitore, ndërsa për kampion katër fitore.



Ballkani shkatërron Dukagjinin, Ferizaj mposhti Feronikelin ‘74

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 PRILL - Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Ballkani është treguar skuadër e pamëshirshme në përballje me Dukagjinin, pasi e mposhti në Klinë me rezultat 0-5. Kjo ndeshje i ka takuar javës së 28-të në Superligë. Mysafirët ishin skuadër në pjesën e parë dhe arritën të shënojnë dy gola nëpërmjet sulmuesit Sunday Adetunji. Edhe në pjesën e dytë, Ballkani ishte skuadër me e mirë dhe arriti të shënon edhe dy gola të tjerë. Në minutën e 48-të, Bleart Tolaj realizoi për rezultat 0-3. I njëjti futbollist realizoi edhe golin e katërt, në minutën e 64-të.

Në fund të ndeshjes, Karrica vulosi rezultat 0-5. Pas këtyre tri pikëve, Ballkani përforcon vendin e dytë me 50 pikë, dhjetë me pak se skuadra lidere, Drita. Dukagjini i Ismet Munishit mbetet në vendin e shtatë me 35 pikë. Ndërsa ndeshja tjetër mes Feronikelit ‘74 dhe Ferizajt përfundoi me fitoren e mysafirëve me rezultat 0-1. Golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi Abdul në fillim të pjesës së dytë. Ferizaj ngritën në pozitën e pestë me 38 pikë, kurse Feronikeli ‘74 renditet në vendin e fundit me 14 pikë. Skuadra nga Drenasi sezonin tjetër pritet të bëjë gara në Ligën e Parë. Ndërsa sot (e shtunë) do të zhvillohet një tjetër ndeshje shumë



interesante ku do të takohen Suhareka dhe Prishtina. Të dyja këto skuadra kanë nevojë për pikë dhe kjo ndeshje pritet të jetë shumë interesante. Të dielën zhvillohen dy ndeshjet tjera, ku Malisheva e pret në

stadiumin “Liman Gegaj”. Dritën e cila është afër të siguron titullin në elitë. Malishevasit kanë potencial që të ndalin gjilanasit dhe gara për titull të vazhdojë deri në xhirot e fundit. Në ndeshjen tjetër

Gjilani e pret Llapin që sivjet ka krizë rezultatesh në elitë. Gjilani synon fitore për të përforcuar pozitën e katërt dhe të ëndërrojë edhe për pozitën me lartë, kurse Llapit i duhen tri pikë që të ngushtojë diferencën e pikëve me skuadrat tjera.

SUPERLIGA - Java e 28

Feronikeli ‘74 - Ferizaj 0-1
Dukagjini - Ballkani 0-5

Të shtunën takohen:
Suhareka - Prishtina

Të dielën takohen:
Malisheva - Drita
Gjilani - Llapi

Valiev pas skandalin në Kampionatin Evropian: Rusisë ia kam shlyer të gjitha detyrimet

TIRANË, 11 PRILL - Shqipëria ka shkëlqyer në Kampionatin Evropian të Mundjes që po zhvillohet në Sllovaki, duke siguruar dy medalje: ari për Chermen Valiev dhe bronzi për Zelimkhan Abakarov. Megjithatë, festa për arritjen historike të Valievit u zbeh nga një incident i rëndë gjatë ceremonisë së ndarjes së medaljeve. Presidenti i Federatës Ruse të Mundjes dhe njëkohësisht zëvendëspresident i Federatës Botërore të Mundjes, Mikhail



Mamiashvili, shfaqti sjellje të pahijshme ndaj kampionit

shqiptar. Ai i vendosi medaljen Valievit me një gjest

të shëmtuar dhe e quajti atë “tradhtar të atdheut”, pas humbjes që Valiev i shkaktoi kampionit rus Zaurbek Sidakov në finalen e peshave 74 kg në stilin e lirë. Vetë Valiev e ka konfirmuar ngjarjen në një prononcim për “Match TV”: “Mikhail Mamiashvili më quajti tradhtar të atdheut. Isha i hutuar. Iu afrova për t’u sqaruar, por organizatorët ndërhyjnë dhe më larguan”, ka thënë ai. Chermen Valiev, i cili në vitin 2024 mori shtetësinë shqiptare, është

tashmë një figurë historike për sportin shqiptar, duke fituar medaljen e parë olimpike për Shqipërinë dhe tashmë edhe titullin kampion Evrope. Ai theksoi se kalimi i tij për të përfaqësuar Shqipërinë është bërë në mënyrë të rregullt dhe transparente: “Gjithçka u realizua në përputhje me rregullat ndërkombëtare. Kam paguar 5 mijë euro për Federatën Ndërkombëtare dhe po aq për Federatën Ruse të Mundjes. Nuk kam shkelur asnjë rregull.”

Berisha rikthehet në Suedi, firmos me BK Hacken

GOTHENBURG, 11 PRILL - Klubi suedez, BK Hacken ka konfirmuar zyrtarisht se ka nënshkruar një kontratë me portierin shqiptar, Etrit Berisha, deri në fund të sezonit aktual, i cili ka filluar vetëm para dy xhirove. Etrit Berisha do t’i kthehet futbollit pas disa muajve pushim, pasi ka nënshkruar me klubin nga Superliga e Suedisë, BK

Hacken. Është vet klubi suedez që ka njoftuar me anë të faqeve zyrtare se ka nënshkruar kontratë të vlefshme deri në fund të sezonit me Berishën. “Portieri i merituar Etrit Berisha forcon BK Hacken. Etrit Berisha ka një CV të fortë që përfshin 163 ndeshje të Serie A, 90 ndeshje në Allsvenskan dhe 81 ndeshje me kombëtaren e

Shqipërisë”. “Tani ai është gati për BK Hacken me një kontratë që zgjat deri në fund të sezonit”, thuhet në njoftim e klubit suedez. Me nënshkrimin u ndje i lumtur edhe 36-vjeçari prishtinas, i cili edhe në të kaluarën ka luajtur në kampionatin elitë suedez. “Ndihehem mirë të kthehem te Allsvenskan dhe te një klub si BK Hacken që ka

potencial të mirë dhe shumë lojtarë të mirë”, ka thënë Berisha. Për 36-vjeçarin nga Prishtina, ky është një rikthim në një kampionat që e njeh mirë, pasi më parë ka luajtur për Kalmar FF në Suedi, ku u shqua për paraqitjet e tij të mira. Pas aventurës në Suedi, Berisha zhvilloi një karrierë të gjatë në Serinë A, duke mbrojtur portën e skuadrave



si Lazio, Atalanta, SPAL, Torino dhe Empoli, me mbi 160 ndeshje në elitën e futbollit italian.

Salah rinovon kontratën me Liverpoolin

Liverpool, 11 prill - Mohamed Salah ka nënshkruar një kontratë të re me Liverpoolin, duke e zgjatur qëndrimin e tij në klub deri në vitin 2027. Kontrata e mëparshme e Salahut ishte planifikuar të përfundonte në fund të

këtij sezoni, por me këtë marrëveshje të re, ai do të vazhdojë të jetë pjesë e ekipit për të paktën edhe dy vite të tjera. Në një deklaratë për faqen zyrtare të klubit, Salah shprehu entuziazmin e tij për të ardhmen. “Jam shumë i

lumtur që do të vazhdoj këtu. Kemi një skuadër të shkëlqyer dhe besoj se mund të fitojmë trofe të mëdhenj së bashku. Kam kaluar vitet më të mira të karrierës sime këtu dhe shpresoj që të vazhdojmë të arrijmë suksese”, ka

thënë Salah. Ky rinovim është një lajm i mirë për tifozët e Liverpoolit, pasi Salah ka qenë një nga lojtarët më të rëndësishëm të ekipit gjatë viteve të fundit, duke kontribuar ndjeshëm në sukseset e klubit.



Nderohet me mirënjohje Isuf Lumi

SUHAREKË, 11 PRILL - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka nderuar me mirënjohje, të ndjerin Isuf Lumi, i cili ishte kryetar i parë i FBK-së dhe sekretar i Përgjithshëm. Ceremonia u organizua para ndeshjes ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Pejës, çerekfinalja e “play-off”-it të ProCredit Superligës. Nënkryetari i FBK-së për familjen Lumi ka ndarë mirënjohjen, fanellën me numër 15 në kujtim të 15 vjetorit të ndërrimit të jetës së tij, si dhe një buqetë me lule. Mirënjohjet i kanë pranuar familja e ngushtë e Lumit, duke u ndjerë krenarë të nderuar për vlerësimin që i jepet Isuf Lumit. I ndjeri Isuf Lumi ka qenë kryetari i parë i FBK-së pas mëvetësimin të sportit të Kosovës, ndërsa pasluftës për disa vite radhazi ka qenë në rolin e Sekretarit të Përgjithshëm të FBK-së, duke kontribuar kështu maksimalisht në të gjitha mënyrat në zhvillimin e këtij sporti në vendin tonë. Në vitin 1991, ishte ndër nismëtarët e themelimit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, ndërkaq në Kuvendin e parë zgjedhur,



ishte zgjedhur kryetar i Parë i Federatës së Basketbollit të Kosovës. Në mandatin e parë të themelimit, Isuf Lumi udhëhoqi me shumë sukses hapat e parë të organizimit të pavarur të sportit të basketbollit në Kosovë. Nga viti 1995, Isuf Lumi vazhdoi të ishte pjesë e Bordit udhëheqës të Federatës, si dhe ishte në të njëjtën kohë edhe delegat në ndeshjet e basketbollit. Funksione të ndryshme dhe aktivitetin e tij,

Isuf Lumi e vazhdoi edhe pas përfundimit të luftës, ku tashmë beteja kryesore ishte anëtarësimi në FIBA. Fatkeqësisht, frytet e punës së tij dhe suksesin e madh të anëtarësimin në FIBA, Isuf Lumi nuk arriti ta shoh pasi që ndërroi jetën në vitin 2010, kur edhe ishte në mandatin e Sekretarit të Përgjithshëm i FBK-së. FBK-ja do të kujton gjithmonë kontributin e tij të madh në basketbollin e Kosovës.

Clevelandi humbet por ruan kreun në Lindje



Indianapolis, 11 prill - Skuadra e Cleveland Cavaliers u mund me rezultat 114-112 nga Indiana Pacers, por ruan kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes. Shtatë lojtarë të

skuadrës së Indianan realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua Haliburton me 23 pikë. Fitore të lehtë korri Milwaukee, që mundi me rezultat 136-111 New Orleans. Antetokounmpo

REZULTATET	
Detroit - New York	115-106
Indiana - Cleveland	114-112
Brooklyn - Atlanta	109-133
Milwaukee - New Orleans	136-111
Memphis - Minnesota	125-141

me 28 pikë e 11 rebound ishte lider në fushë për Bucks. Pa probleme fiton edhe Minnesota, që falë 44 pikëve të Anthony Edwards mundi me rezultat 141-125 Memphisin. Detroiti triumfoi me rezultat 115-106 në fushën e tij ndaj New York, sfidë ku u dallua Cunningham, që realizoi 36 pikë. Protagonist me 38 pikë ishte edhe Risacher për Atlanta, që triumfoi me rezultat 133-109 në fushën e Brooklyn.

Flick thyen rekordin historik të Enriques

Barcelona po kalon një formë spektakolare në sezonin 2024-2025, duke regjistruar 23 ndeshje radhazi pa humbje në të gjitha kompeticionet, një rekord i ri në historinë e klubit, që kalon edhe serinë e

famshme të vitit 2016 nën drejtimin e Luis Enrique (22 ndeshje). Fitorja 4-0 ndaj Borussia Dortmundit në çerekfinalin e Ligës së Kampionëve i dha skuadrës së Hansi Flick një tjetër moment

historik. Që nga 21 dhjetori 2024, Barça ka regjistruar 19 fitore dhe 4 barazime, me 71 gola të shënuar dhe vetëm 21 të pësuar. Ecuria përfshin ndeshje të La Ligas, Ligën e Kampionëve, Kupës së

Mbretit dhe Superkupës së Spanjës. Seria filloi më 3 janar 2025 ndaj Barbastro (0-4), ndërsa vetëm katër ekiye kanë arritur të shmangin humbjen. Ndër fitoret më të spikatura është triumfi 5-2

ndaj Real Madridit në finalen e Superkupës. Barcelona e Flick ka tejkaluar zyrtarisht fillimin më të mirë të vitit në historinë e klubit, duke lënë pas edhe skuadrën legjendare të vitit 2016.

SHKURT

Muriqi mungon një muaj

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi do t'i mungoj Mallorcas edhe për një muaj, edhe pse hyri në formë javëve të fundit. Sulmuesi “dardan” u lëndua gjatë ndeshjes kundër Celtas në ligë, duke pësuar një lëndim në gjurin e këmbës së majtë, raporton “Estadio Deportivo”. Muriqi do të detyrohet të qëndrojë jashtë fushës së blertë nga tri deri në katër javë, duke i shkaktuar probleme të reja trajnerit bask në fazën e fundit të kampionatit. Mallorca është në vendin e nëntë në tabelë, me 8 pikë larg Betisit në vendin e gjashtë në garën për t'u kthyer në garat evropiane.

Cana: Tare është i duhuri për Milanin

Ish-kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana ka thënë se Igli Tare është i duhuri për drejtor Sportiv të Milani dhe se rezultatet flasin vetë për ish-numrin dy të klubit të Lazios. Duke për mediat italiane ish-mbrojtësi i Lazios, Lorik Cana tregoi përvojat e tij të përbashkëta me Igli Taren, në klubin roman dhe një nga kandidatët kryesorë për të marrë frenat e merkatos të shtatë herë kampionët e Evropës. “Ne njihemi prej 25 vitesh. Për mua në radhë të parë ai është një mik dhe padyshim që konsiderata ime për të qenë shumë e lartë, para së gjithash në personale. Si menaxher, faktet flasin për të. Të ardhmen, por ne shqiptarët i urojmë më të mirën, sepse është një pikë referimi në aspektin sportiv në vend”, ka deklaruar Cana.

Hamilton: Mos prisni që unë të bëj magji me këtë Ferrari

Këtë fundjavë, botërori i Formula 1 spostohet në Bahrein, aty ku Ferrari synon të ndryshojë kurs. Disa risi që do të sjellë “kokëkuqja” pritet që të japin efekt. Ato do të testohen sot, gjatë sesionit të parë të provave të lira. Ndaj, pritshmëritë për Lewis Hamilton dhe Charles Leclerc në këtë garë janë të larta. Piloti britanik, i ardhur në janar të Ferrari, kërkon të qëndrojë me këmbë në tokë dhe të presë rezultatet që do të ofrojë pista dhe të mos ëndërrojë. Në një intervistë, Hamilton ka thënë: “Mos prisni asgjë magji nga mua, thjesht të presim atë që do të ofrojë pista këtë fundjavë. Ne po punojmë sa më shumë që të mundemi, kështu që nuk mund të them asgjë tjetër”. “E dimë që rezultatet nuk janë ato që kemi shpresuar, por ne besojmë se situata mund të ndryshojë. Gjithsesi, kjo makinë ka ende shumë për t'u përmirësuar dhe ne synojmë të nxjerrim të gjithë potencialin e saj”, ka deklaruar Hamilton.

Vinicius refuzon ofertën stratosferike nga Arabia Saudite

Sipas “Cadena SER”, sulmuesi brazilian i Real Madridit, Vinicius Junior ka refuzuar një ofertë financiare shumë të lartë nga Arabia Saudite. Klubet saudite thuhet se kanë ofruar një kontratë pesëvjeçare me një vlerë totale prej një miliard eurosh për të bindur lojtarin. Në fakt, Vinicius nuk duket i interesuar për një marrëveshje kaq afatgjatë. Negociatat mes Vinicius dhe Real Madrid për një rinovim të kontratës thuhet se janë në një fazë të avancuar, me një zgjatje të mundshme të marrëveshjes për dy ose tre vjet të tjera. Vinicius Junior ka veshur fanellën e “Los Blancos” që nga viti 2018, duke u bërë shpejt një element thelbësor për skuadrën e drejtuar nga Carlo Ancelotti.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “DSG Holding” L.L.C. Klinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Fabrikën për Ambalazhimin e Ujit “Sibora” në Gremnik, Klinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.06.2025 në ora 09:00 në objektin e SHFMU “Zgjimi Gremnik” në fshatin Gremnik, Klinë, do të organizohet debat publik nga Kompania “DSG Holding”L.L.C. Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “DSG Holding”L.L.C. Klinë, për Pëlqim Mjedisor, – për Ambalazhimin e Ujit “Sibora” në Gremnik, Klinë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Tahirsylaj Mineral” Shpk Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Fabrikën për Ambalazhimin e Ujit, në Isniq, Deçan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.06.2025 në ora 11:00 në objektin SHFMU “Isa Boletini” në fshatin Isniq, Komuna e Deçanit, do të organizohet debat publik nga Kompania “Tahirsylaj Mineral” Shpk Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Tahirsylaj Mineral” Shpk Pejë, për Pëlqim Mjedisor, – për Fabrikën për Ambalazhimin e Ujit, në Isniq, Deçan

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të U.D. Kryeshefit Ekzekutiv të datës 11.04.2025 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 12.04.2025 të shpall:

KONKURS

Një (1) Vozitës i kategorisë “C”- Njësia në Skenderaj, me kohë të caktuar (në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 11-04-66

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Lartësia e pagës mujore: 428.56 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit;
- Para daljes në teren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencën punët e kryera , vërejtejet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njejten e kthen te dispeçeri;
- Vendos (monton) letërën e re të tahogرافit ndërsa letërën paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letërën e tahogرافit ka obligim që në të shënon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopata, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon,largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhërësen e punës;
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Cdo sjellje të pandërgjegjëshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi drejtpërdrejtë;
- Vozitësi e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jasht planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër , dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit drejtpërdrejt, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes;

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.

Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraparak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë ne çdo fazë të procedurës së rekrutimit , ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e patentë Shoferit kategoria "C",
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 12.04.2025 deri me 26.04.2025, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M ."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dorentina Brahimi shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mjekësisë “Dr. Xheladin Deda” Mitrovicë.

Nikolina Dushaj B.I. shpall të pavlefshme numrin Unik të biznesit me nr. 811309865 të lëshuar nga ARBK.

Fatmir Hakaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m.l.e “Kadri Kusari” Gjakovë.

Baresha Music SH.P.K. me nr Unik. 811499228 shpall të humbur certifikatën e TVSH-së me nr. 330504127.

- Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9

- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

-Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimanzit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

